



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 101

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 9 korrik 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 4.7.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 6347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 4.7.2018	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Polican, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendndodhje në Polican, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Polican, të qarkut të Beratit”, të ndryshuar..... 6347
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 4.7.2018	Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që do të ndiqen për këtë qëllim.. 6349
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 4.7.2018	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për përballimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.6.2017, zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kavajë, të datës 25.6.2017, dhe zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kolonjë, të datës 20.11.2016..... 6362

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 408, datë 4.7.2018

Për miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për mbështetjen e projektit “Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën e tregut, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”

6362

**VENDIM****Nr. 401, datë 4.7.2018**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN
E PERSONAVE TË SHPALLUR
SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

1. MYRNA; AJIJUL; MABANZA;

2. ABDULPATTA; ESCALON; ABUBAKAR.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat dhe

kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM**Nr. 402, datë 4.7.2018**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
POLIÇAN, TË PRONËS NR. 1069, ME
EMËRTIM “KOMBINATI MEKANIK
ZONA B”, ME VENDNDODHJE NË
POLIÇAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN
NR. 207, DATË 9.3.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË POLIÇAN, TË QARKUT TË
BERATIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendndodhje në Poliçan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për vendosjen e ndërmarrjes së shërbimit pyjor, për magazinimin dhe përpunimin e lëndës drusore, të materialeve të ndërtimit, instalimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë Poliçan, për zbatimin e projekteve në funksion të zhvillimit



social-ekonomik të zonës, si dhe për realizimin e funksioneve ekonomike dhe të funksioneve të tjera sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendndodhje në Poliçan, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Poliçan, miratuar me vendimin nr. 207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.


3. Bashkisë Poliçan i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Polican, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryerëgjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



**VENDIM****Nr. 405, datë 4.7.2018**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI
DETYRIMIN PËR VETËDEKLARIM TË
ADRESËS NGA SHTETASIT
SHQIPTARË QË JETOJNË JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE PROCEDURAVE
PËRKATËSE QË DO TË NDIQEN
PËR KËTË QËLLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit, dokumenteve shoqëruese të tij, si dhe administrimit të tyre nga autoritetet përgjegjëse, Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2. Njoftimi i detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse bëhet sipas këtyre mënyrave:

a) Nëpërmjet publikimit në faqet zyrtare elektronike të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

b) Nëpërmjet programeve, reklamave dhe spoteve për transmetim nga operatorë radiotelevizivë, fletëpalosjeve, takimeve me përfaqësues të shoqatave shqiptare jashtë vendit dhe të organizatave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e emigrantëve.

3. Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit të publikuar në faqen zyrtare të dy ministrive përgjegjëse në dy mënyra:

a) Në mënyrë elektronike;

b) Në mënyrë manuale.

4. Shtetasit, të cilët aplikojnë në mënyrë elektronike, ndjekin procedurën e përcaktuar në manualin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Shtetasit, të cilët aplikojnë në mënyrë elektronike, vetëm për t'u njohur dhe për të printuar nga sistemi formularin tip të vetëdeklarimit, ndjekin njërin nga procedurat e mëposhtme:

a) Pasi të kenë shkarkuar, printuar dhe plotësuar formularin, sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në të, e dërgojnë atë me postë pranë misionëve tona diplomatike ose posteve konsullore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet banesa e tyre;

b) Pasi të kenë printuar dhe plotësuar formularin sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në të, paraqiten fizikisht pranë misionëve tona diplomatike ose posteve konsullore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet banesa e tyre.

6. Shtetasit, të cilët paraqiten pranë zyrave përgjegjëse dhe që nuk kanë aplikuar dhe siguruar formularin, sipas përcaktimit të pikës 5, pajisen me formular nga nëpunësi përgjegjës dhe e plotësojnë atë në prani të tij.

7. Në rastet kur shtetasi plotëson formularin në mënyrë elektronike dhe e konfirmon atë sipas manualit, nuk ka nevojë të paraqitet pranë nëpunësit përgjegjës, pasi ky i fundit ka mundësinë e printimit të tij nga programi i regjistrimit të adresës.

8. Në rastet kur aplikimi i formularit plotësohet në mënyrë manuale, nëpunësi përgjegjës kryen veprimet për identifikimin dhe regjistrimin e adresës në programin e regjistrimit të adresës, sipas manualit të miratuar nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

9. Nëpunësi përgjegjës, pasi merr formularin e aplikimit në një nga format e parashikuara në këtë vendim dhe pasi ka kryer veprimet sipas pikës 8 të këtij vendimi, përgatit praktikën për konfirmim të adresës nëpërmjet shërbimit postar.

10. Bëjnë përjashtim nga konfirmimi i adresës, nëpërmjet shërbimit postar, rastet kur shtetasi plotëson dhe dorëzon formularin me paraqitjen e tij fizike pranë nëpunësit përgjegjës dhe, bashkë me formularin, paraqet çdo dokument ligjor, i cili provon adresën e tij, të njohur nga autoritetet e vendit ku jeton.



11. Në rastet kur adresa konfirmohet nëpërmjet shërbimit postar, nëpunësi përgjegjës kryen veprimet përfundimtare për regjistrimin e adresës së shtetasve, të cilët janë deklaruar në formular dhe janë verifikuar si pjesëtarë të familjes së deklaruesit, sipas manualit të miratuar për këtë qëllim.

12. Pas përfundimit të procedurës së identifikimit dhe regjistrimit të adresës, nëpunësi përgjegjës do të administrojë dokumentacionin, me anën e të cilit u krye regjistrimi i adresës, sipas rastit:

a) Për aplikimin në mënyrën elektronike dhe në mënyrën manuale para nëpunësit përgjegjës do të ruhet konfirmimi i sjellë nga shërbimi postar;

b) Në rastet kur aplikimi kryhet sipas pikës 10, të këtij vendimi, atëherë nëpunësi përgjegjës do të ruajë, përveç formularit të vetëdeklarimit, edhe kopjen e dokumentacionit me anë të të cilit shtetasi ka provuar adresën e tij.

13. Dokumentacioni, në bazë të të cilit kryhen veprimet për regjistrimin e adresës, siç është përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, do të ruhet për një afat 5-vjeçar.

14. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen përkatësisht nga Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, parashikuar në buxhetin e vitit 2018.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MANUAL PËR VETËDEKLARIMIN E ADRESËS SË SHTETASVE SHQIPTARË, TË CILËT JETOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. HYRJË

Ky manual do të shërbejë si udhëzues për të gjithë përdoruesit që do të përdorin portalin e identifikimit dhe regjistrimit të adresës së shtetasve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Portali do të krijojë mundësinë e kryerjes së veprimeve nga ana e nëpunësve përgjegjës.

Pas deklarimit të të dhënave, nga ana e shtetasve objekt i detyrimit, në këtë portal, përdoruesi ka mundësinë të printojë direkt formularin për deklarimin e adresës, duke ia vënë në dispozicion shtetasit sipas kërkesës së tij.

Rolet në portal:

Në portal operon nëpunësi përgjegjës si operator *back office*:

- nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki
- nëpunësit e autorizuar të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë.

Nëpunësit përgjegjës do të pajisen me kredenciale të posaçme për të përdorur portalin (emër dhe fjalëkalim).

2. PREZANTIM ME PORTALIN

Portali *online* që do të vijë në ndihmë të shtetasve shqiptarë për deklarimin e adresës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

[KREJ](#) [RRETH NESH](#) [NA KONTAKTONI](#)

— Ministria e Brendshme —

DEKLARIMI I ADRESAVE PER SHQIPTARET QE JETOJNE JASHTË SHTETIT





KONFIRMO ADRESEN

Përdorni të dhënat e marra me shërbimin postar për të kryer konfirmimin e adresës



REGJISTRO

Plotësoni fushat e nevojshme për të deklaruar adresën tuaj me të gjitha detajet



HYR

Hyni në sistemin me kredencialet përkatëse

Në faqen kryesore do t'ju jepet mundësia për të vijuar me deklarimin e adresës, duke plotësuar fushat ku deklaron me saktësi informacionet e tij personale lidhur me vendbanimin e tij aktual.



REGJISTRO ADRESEN JASHTË SHTETIT

Te dhënat personale

Numri Personal

Emri

Atesia

Mbiemri

Datelindja

Shtetësia e pare

Shtetësia 1

Shtetësia e dyte

Shtetësia 2



Në fund të formularit jepet mundësia për të **shtuar** anëtarët e tjerë të familjes, të cilët jetojnë në të njëjtin apartament me të njëjtat të dhëna rreth adresës së banimit.

Shto anetare te tjere te familjes

Emri	Atesia	Mbiemri	Numri Personal	
Vendosni emrin	Vendosni atesine	Vendosni mbiemrin	Vendosni nr. pers.	-

+ Shto nje pjesetar familje

REGJISTRO

Pas plotësimit me sukses të të gjitha të dhënave, qytetari duhet të shtypë te butoni “REGJISTRO” për të kryer deklarinin me sukses.

Shto anetare te tjere te familjes

Emri	Atesia	Mbiemri	Numri Personal	
Vendosni emrin	Vendosni atesine	Vendosni mbiemrin	Vendosni nr. pers.	-

+ Shto nje pjesetar familje

REGJISTRO

Për sa i përket ambientit të punës së punonjësit, ai duhet të logohet në sistem për të parë dhe për të konfirmuar deklarinimet e realizuara nga qytetarë të ndryshëm. Për t'u loguar në sistem, mjafton të klikohet në menunë “HYR” në faqen kryesore të adresarit.

KREJU RRETH NESH NA KONTAKTONI

— Ministria e Brendshme —

DEKLARIMI I ADRESAVE PËR SHQIPTARËT QË JETOJNË JASHTË SHTETIT

KONFIRMO ADRESEN

Përdorni te dhënat e marra me shërbimin postar për të kryer konfirmimin e adresës

REGJISTRO

Plotësoni fushat e nevojshme për të deklaruar adresën tuaj me të gjitha detajet

HYR

Hyni në sistemin me kredencialet përkatëse

Më pas punonjësi duhet të plotësojë kredencialet përkatëse dhe të logohet në sistem me anë të butonit “LOGIN”.



HYR NE SISTEM

Përdorni kredencialet për të loguar në sistem

E-Mail Address

Password

LOGIN

[Forgot Your Password?](#)

Ndërfaqja e parë që do t'ju shfaqet pas logimit është paraqitur më poshtë.

Admin - AL

Test Account

Menuja

- Përdoruesit
- Rolet
- Deklarimi i Adresave**

Home / Deklarimi i rugeve

Back Add

Potenciali fushat

Numri Personal Kërko sipas nr. personal	Emri Kërko sipas emrit	Atesia Kërko sipas atesias
Mbiemri Kërko sipas mbiemrit	Shteti Kërko sipas shtetit	Qyteti Kërko sipas qytetit
Kodi Postar Kërko sipas kodit postar	Rruga Kërko sipas rruges	Numri Kërko sipas numrit

Kërko Reset

Deklarimi i Adresave

Show 10 entries

Search:

Emri Atesia Mbiemri	Nr. Personal	Shteti	Qyteti	Statusi	
Perikli Fotinaq Angjeli	JK108765LM	United Kingdom	East Midlands	Agjencim i Ri	✓ ✗ ! 📄

Në fushën e deklarimit të adresave do të paraqiten qartë deklarimet e adresave ndaj të cilave mund të ndërmerrni disa vendime.

Deklarimi i Adresave

Show 10 entries

Search:

Emri Atesia Mbiemri	Nr. Personal	Shteti	Qyteti	Statusi	
Perikli Fotinaq Angjeli	JK108765LM	United Kingdom	East Midlands	Agjencim i Ri	✓ ✗ ! 📄


Showing 1 to 1 of 1 entries

Previous 1 Next

Ky aplikim mund të refuzohet ose të vendoset në statusin “në proces” me anë të butonave në anën e djathtë të secilit aplikim.



Në momentin e vendosjes në proces ose të refuzimit të aplikimit, një dritare dialoguese shfaqet për të dhënë një shënim mbi veprimin e ndërmarrë.




Shtoni shenim per vendimin tuaj

Shenim

Plotesoni shenime per vendimin tuaj (opsionale)

Vendose ne Proces **Close**

Pas vendosjes me sukses “në proces”, në ndërfaqe do të shfaqet statusi aktual i aplikimit.




Emri Atesia Mbiemri	Nr. Personal	Shteti	Qyteti	Statusi	
Perikli Fotinaq Angjeli	JK108765LM	United Kingdom	East Midlands	In Process	    

Showing 1 to 1 of 1 entries


Previous **1** Next

Në momentin e vendosjes “në proces” të aplikimit, këtij aplikimi i gjenerohen dy kode unike automatikisht, të cilët mund të shihen në ndërfaqen INFO.



Emri	Perikli
Atesia	Fotinaq
Mbledhri	Angjeli
Numri Personal	JK108765LM
Kodi i Verifikimit	3qHUUeIDqt dfsd
Shteti	United Kingdom
Qyteti	East Midlands
Shtetesia 1	Shqiptar
Shtetesia 2	Shqiptar
Kodi Postar	2983-7
Rruga	G G F, Rushworth Street, London, United Kingdom
Numri i Apartamentit	23
Lokalliteti	East Through

Ambasada i dërgon me **postë** qytetarit **kodin e verifikimit** dhe, në këtë mënyrë, i lë atij mundësinë e konfirmimit të adresës. Pas marrjes së kodit të verifikimit me anë të postës, qytetari drejtohet përsëri në faqen kryesore të adresarit dhe klikon në rubrikën “**KONFIRMO ADRESEN**”.





KONFIRMO ADRESEN

Plotësoni të dhënat për të konfirmuar adresën

Numri Personal

Plotësoni nr. personal

Kodi i Aplikimit

Vendosni kodin e aplikimit...

KONFIRMO

Pasi plotësohen fushat përkatëse, klikohet në butonin “**KONFIRMO**” për të konfirmuar adresën. Pas konfirmimit në panelin e *admin*-it, ndryshohet automatikisht statusi i aplikimit.

Deklarimi i Adresave

Show10entries

Search:

Emri Atesia Mbiemri	Nr. Personal	Shteti	Qyteti	Statusi	
Perikli Fotinaq Angjeli	JK108765LM	United Kingdom	East Midlands	I Aprovuar	

Showing 1 to 1 of 1 entries

Previous

1

Next

3. Veprimet që do të kryhen nga punonjësi përgjegjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

3.1 Si mund të hyni në sistem dhe fushat e kërkimit

Vendosim emrin e përdoruesit, i cili është: emër.mbiemër@moi.gov.al

Poshtë tij vendosim fjalëkalimin që ju është caktuar. Më pas do t’ju shfaqet një tjetër tabelë që do t’ju kërkojë të ndryshoni fjalëkalimin. Te kutia e parë do të vendosni fjalëkalimin që ju ishte caktuar, kurse te dy kutitë e tjera një fjalëkalim që ju preferoni dhe që e mbani mend lehtë.



Portali i shërbimit të
Gjendjes Civile

DPGJC

Emri i përdoruesit

Fjalëkalimi

Hyrje

HELPDESK
Tel : 0686545001
Tel : 0686545002
Tel : 0686545003

Pasi t'i plotësoni këto fusha, do t'ju shfaqet kjo pamje:

DPGJC Aplikacion Ndrysho fjalëkalimin Ndihmë    Dil

Miresevini ne portalin e ri, Oct 29, 2015 10:05:48 PM

Tek mesazhet (messages) mund te dergoni direkt mesazhet tek helpdesk, pa pasur nevojte te hyni te emaili. Tek dokumentat (documents) mund te lexoni dokumentat e rinj pa hyre tek ftp.

++ Regjistri Kombëtar i Shtetasve ++

Document & Messages

Regjistri Kombëtar i Shtetasve - Test



Këtu keni dy mënyra për t'u futur në sistem: mjedisi i testimi dhe mjedisi i *Production*-it. Nëse klikon te Regjistri Kombëtar i Shtetasve, kalon direkt në *Production*. Pra, këtu, të gjitha veprimet që ju kryeni ruhen në sistemin real të Regjistrat Kombëtar. Nëse klikoni te Regjistri Kombëtar i Shtetasve-Test, mund të kryeni çfarëdo veprim që dëshironi të provoni dhe nuk ruhet në sistemin real të regjistrat, pra, është mjedis thjesht për të testuar.

Pasi klikojmë në njërin nga këto mjedise, na shfaqet kjo pamje:

Kjo është fusha e kërkimit. Siç shihet, mënyrat e kërkimit janë të shumta. Mirë është nëse do të kishit sa më shumë të dhëna për një person në mënyrë që të ngushtohet fusha e kërkimit dhe të dalin sa më pak shtetas me ato të dhëna. Nëse ju keni vetëm emrin dhe mbiemrin si të dhëna, mund të dalin më shumë se një person me ato të dhëna, varet sipas rastit. Në këtë mënyrë do të jetë procedurë më e gjatë deri në gjetjen e personit të kërkuar. Për këtë arsye, është mirë të kesh më shumë se 2 të dhëna.

Ekziston edhe një mënyrë, e cila përdoret në rastet kur emri ose mbiemri nuk është i qartë. Për këto raste vepohet si më poshtë:



Arsyeja

Të dhëna personale

Numri personal

Emri

Mbiemri

Datëlindja

Vendlindja

Shtetësia

Seksi ☐ Mashkull ☐ Femër

Adresa

Rrethi

Vendi

Rruga

Numri i ndërtesës

Në rastin kur emri ose mbiemri nuk është i qartë ose i sigurt, mund të vendosni vetëm tri shkronjat e para dhe pastaj të vendosni simbolin*. Kjo do të thotë që, pas shkronjës së tretë, sistemi kërkon të gjithë emrat ose mbiemrat që fillojnë me ato tri shkronja. Por, për t'i shërbyer sa më shpejt qytetarit, është mirë të keni sa më shumë të dhëna për të kërkuar.

Një mënyrë unike dhe e shpejtë është nëse keni numrin personal të personit, sepse, nëse e kërkonit me numër personal, del menjëherë ai person që kërkonit - numri personal është unik dhe i përket vetëm një personi.

3.2 Si të plotësojmë adresën e shtetasve shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë

Procesi i regjistrimit

Kërko person | kërkim i zgjeruar personi | Personat e gjetur | Të dhëna personale | Dokumente identiteti | Shtetësia | Bllokim i informacionit

Informacion | Personi u gjet.

Pastro | **Kërko**

Arsyeja

Të dhëna personale

Numri personal

Emri

Mbiemri

Datëlindja

Vendlindja

Shtetësia

Seksi ☐ Mashkull ☐ Femër

Këtu kërkojmë shtetasin

Pasi kemi klikuar tek opsioni “Kërko”, do të shfaqen 1 ose më shumë shtetas me ato të dhëna. Pasi kemi gjetur personin e duhur, do ta përzgjedhim dhe do të klikojmë te rubrika “Ndrysho vendbanim”:



Procesi i regjistrimit

- Kërko person
- Krijo person
- Ndrysho person
- (Jo) bllokim personi
- Ndrysho emrin/mbiemri
- Ndrysho vendbanimin
- Regjistro vendbanimin
- Korrigjo vendbanimin
- Familja
- Printo certifikatën
- Printo ndryshimin e pe
- Dokumentet e lëshuar
- Printo certifikatën histo
- Përfshirimi nga zgjedh

Kërko person | kërkim i zgjeruar personi | **Personat e gjetur** | Té dhëna personale | Dokumente identiteti | Shtetësia | Bllok

Informacion | **Personi u gjet.**

1 - 10 (151)

Numri personal: **Përzgjedhim personin**

Numri personal	Emri i personit	Datëlindja/vendlindja
901040360	AUREL HOXHA	18.02.1988/Suk 2,Fier
901040360	Artan Hoxha	18.02.1988/Suk 2,Fier

Lloji i vendb. Bashkia/Komuna Rruga

K Suk 2

Numri personal: F901040360

Pasi kemi klikuar “Ndrysho vendbanim”, do të shfaqet pamja si më poshtë:

Procesi i regjistrimit

- Ndrysho emrin/mbiemri
- Ndrysho vendbanimin**
- Regjistro vendbanimin
- Korrigjo vendbanimin
- Familja
- Printo certifikatën
- Printo ndryshimin e pe
- Dokumentet e lëshuar
- Printo certifikatën histo
- Përfshirimi nga zgjedh
- Raportim
- Anulo veprimin e fundit
- Anulo veprimin
- Akti i lindjes
- Akti i vdekjes
- Akti i martesës
- Pastimi i të dhënave
- Administrimi i qendrave të
- Parametrit

Numri personal: F901040360

Emri i personit: Artan Hoxha

Datëlindja/vendlindja: 04.01.1959/Durres,Durres

Ndryshuar më: 29.11.2008 14:33

Punonjësi i ZQ/C Migration organizata: 000074

Arsyeja: Zgjidh...

Përfshirimi: Zgjidh...

Lloji i vendb. Bashkia/Komuna

Rruga: Rruga

Numri i ndërtësës: Numri i ndërtësës

Numri i banesës, apt: Numri i banesës, apt

Kodi postar: Kodi postar

Regjistruar nga: Regjistruar nga

Regjistruar për kohësi deri më: Regjistruar për kohësi deri më

Qeradenesi: Qeradenesi

Adresa kryesore/përkohshme

Adresa jashtë vendit

Rrethi: Rrethi

Bashkia/Komuna: Bashkia/Komuna

Vendi: Vendi

Shteti: Shteti

Emri i firmës 1: Emri i firmës 1

Emri i firmës 2: Emri i firmës 2

Personi i kontaktit: Personi i kontaktit

Kufia postare: Kufia postare

Numri i telefonit: Numri i telefonit

Numri i celularit: Numri i celularit

Numri i faksit: Numri i faksit

E-mail: E-mail

Procesi i regjistrimit

- Krijo person
- Ndrysho person
- (Jo) bllokim personi
- Ndrysho emrin/mbiemri
- Ndrysho vendbanimin**
- Regjistro vendbanimin
- Korrigjo vendbanimin
- Familja
- Printo certifikatën
- Printo ndryshimin e pe
- Dokumentet e lëshuar
- Printo certifikatën histo
- Përfshirimi nga zgjedh
- Raportim
- Anulo veprimin e fundit
- Anulo veprimin
- Akti i lindjes
- Akti i vdekjes
- Akti i martesës
- Pastimi i të dhënave
- Administrimi i qendrave të
- Parametrit

Numri personal: F901040360

Emri i personit: Artan Hoxha

Datëlindja/vendlindja: 04.01.1959/Durres,Durres

Ndryshuar më: 29.11.2008 14:33

Punonjësi i ZQ/C Migration organizata: 000074

Arsyeja: Zgjidh...

Përfshirimi: Zgjidh...

Lloji i vendb. Bashkia/Komuna

Rruga: Rruga

Numri i ndërtësës: Numri i ndërtësës

Numri i banesës, apt: Numri i banesës, apt

Kodi postar: Kodi postar

Regjistruar nga: Regjistruar nga

Regjistruar për kohësi deri më: Regjistruar për kohësi deri më

Qeradenesi: Qeradenesi

Adresa kryesore/përkohshme

Adresa jashtë vendit

Rrethi: Rrethi

Bashkia/Komuna: Bashkia/Komuna

Vendi: Vendi

Shteti: Shteti

Emri i firmës 1: Emri i firmës 1

Emri i firmës 2: Emri i firmës 2

Personi i kontaktit: Personi i kontaktit

Kufia postare: Kufia postare

Numri i telefonit: Numri i telefonit


Numri i celularit: Numri i celularit

Numri i faksit: Numri i faksit

E-mail: E-mail

Përzgjedhim opsionin “Vendqëndrim jashtë shtetit”

Te “Lloji i vendbanimit” do të përzgjedhim “Vendqëndrim jashtë shtetit”, pasi shtetasi jeton jashtë Shqipërisë. Në çastin që klikojmë atë opsion, na aktivizohen fushat në të djathtë ku shkruhet “Adresa jashtë vendit”:



Pas plotësimit të adresës së saktë të shtetasit, klikohet butoni [Ruaj].



Shënim: Pasqyrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk ndryshon kodin 10-shifror zgjedhor.

**VENDIM**

Nr. 407, datë 4.7.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR KOMISIONIN QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE PËR HAPJEN E KUTIVE
TË VOTIMIT DHE TË KUTIVE TË
MATERIALEVE ZGJEDHORE TË
ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
DATËS 25.6.2017, ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË, TË
DATËS 25.6.2017, DHE ZGJEDHJEVE TË
PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KOLONJË, TË DATËS 20.11.2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh për përballimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.6.2017, zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kavajë, të datës 25.6.2017, dhe zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kolonjë, të datës 20.11.2016.

2. Efekti financiar prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 408, datë 4.7.2018

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
KONTRIBUTIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCave DHE
EKONOMISË (MARRËSI), DHE
AGJENCISË SUEDEZE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
(SIDA), PËR MBËSHTETJEN E
PROJEKTIT “IMPLEMENTIMI I TAKSËS
SË PASURISË TË BAZUAR NË VLERËN E
TREGUT, VERSIONI 0.93,
DATË 20 SHKURT 2018”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për mbështetjen e projektit “Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën e tregut, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”, nëpërmjet një granti në vlerën prej 36 281 000 SEK (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë) koronash suedeze, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



Kontributi i SIDA-s nr. 11217

MARRËVESHJE KONTRIBUTI

NDËRMJET Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), të përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Shqipëri dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrësi”) për mbështetjen e Projektit “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”.

Duke pasur parasysh se:

- marrësi ka kërkuar kontribut financiar nga Suedia për një Projekt të titulluar “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut” (në vijim i referuar si “Projekti”);
- agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (në vijim i referuar si SIDA) ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur projektin;
- marrësi ka kërkuar të zbatojë Projektin në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze të Taksave (në vijim i referuar si “Autoriteti Suedezi”);
- një marrëveshje Projekti nënshkruhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit Suedezi, bazuar në dokumentin e projektit (bashkëlidhur si shtojca 1).

SIDA dhe Marrësi kanë rënë dakord si më poshtë:

§ 1. Programi/Projekti

Marrësi dhe SIDA bien dakord që Projekti do të realizohet në përputhje me dokumentin e Projektit (shtojca 1), i titulluar “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018.

Qëllimi i Projektit është që të kontribuojë në forcimin e bashkive në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm burimin e të ardhurave të tyre vetjake, duke zbatuar taksën mbi pronën e paluajtshme mbi bazën e vlerës së tregut në ndërtesa, p.sh. njësitë e objekteve.

Tre objektivat specifike të Projektit janë: i) rritja e të ardhurave nga tatimi në pronë; ii) sistemi i tatimit në pronë bazuar në vlerën e tregut; dhe iii) një ekonomi më funksionale.

§ 2. Kontributi suedez

A. SIDA do të vendosë në dispozicion një shumë maksimale të përgjithshme prej tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë

SEK (36 281 000 SEK), në formën e një kontributi grant, për zbatimin e Projektit.

B. Shumat tavan për pagesa nga SIDA do të kufizohen si vijon:

	SEK
Tarifat	11 899 000 SEK
Të rimbursueshme	1 927 000 SEK
Kosto të tjera	22 155 000 SEK
<u>Shuma rezervë</u>	<u>300 000 SEK</u>
Totali	36 281 000 SEK

Buxheti i specifikuar është bashkëlidhur si pjesë e dokumentit të Projektit/shtojca 1.

Kushtet për financimin e SIDA-s janë të specifikuar në dispozitën e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunim me autoritetet, shtojca 2, e cila do të zbatohet për këtë Marrëveshje Kontributi.

§ 3. Kushtet për kontributin suedez

A. Vetëm kostot për aktivitetet e kryera gjatë periudhës që planifikohet të fillojë nga data 15 mars 2018 dhe që do të finalizohet deri më 31 dhjetor 2020, mund të financohen nga kontributi suedez.

B. Nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje ose nëse kushtet për zbatimin e Projektit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, ose qëllimi i Projektit për çfarëdo arsye tjetër nuk pritët të arrihet, SIDA do të ketë të drejtë, në diskrecionin e saj të vetëm, të tërheqë, në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, angazhimin e vet financiar.

C. SIDA dhe Marrësi bien dakord që të bashkëpunojnë për parandalimin e korrupsionit në të gjitha aspektet dhe format gjatë bashkëpunimit dhe zbatimit të Projektit. Marrësi dhe SIDA ndërmarrin më tej marrjen e masave të shpejta dhe përkatëse ligjore dhe të masave të tjera, me qëllim ndalimin, hetimin dhe tarifikimin e çdo personi, subjekti ose tjetër, të dyshuar për korrupsion ose keqpërdorime të tjera me paramendim të burimeve.

§ 4. Kontributi i Marrësit

A. Marrësi do të financojë të gjitha kostot e tjera që nuk mbulohen nga kontributi suedez sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të nevojshme për zbatimin e Projektit, siç janë shërbimet dhe pajisjet në natyrë dhe kostot e tjera lokale të përcaktuara më tej në buxhet.

B. Marrësi do të krijojë, gjithashtu, Njësine për Zbatimin e Projektit, me burime e duhura dhe personel të kualifikuar, të vendosur në ambientet e Marrësit, me qëllim kontraktimin e personelit që i shërben Projektit në kushtet e përzgjedhjes dhe



shpërblimit, siç përcaktohet në dokumentin e Projektit dhe me qëllimin për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve që kërkohen për Projektin.

§ 5. Faturimi dhe pagesa nga SIDA

A. SIDA do të kryejë pagesat për shpenzimet e kryera direkt tek Autoriteti Suedez, siç paraqitet në Marrëveshjen midis agjencive për blerjen e shërbimeve dhe në dispozitat e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet.

B. Përveç kur është rënë dakord ndryshe, faturat do të miratohen nga Marrësi përpara dërgimit të tyre te SIDA. Asnjë pagesë për Autoritetin Suedez nuk do të kryhet paraprakisht.

C. Data përfundimtare për faturimin të SIDA është data e skadimit të kësaj Marrëveshjeje. SIDA nuk do të paguajë faturat e dorëzuara pas kësaj date.

§ 6. Raportimi

A. Marrësi do të japë informacionin përkatës dhe në kohë tek Autoriteti Suedez, me qëllim që t'i mundësojë Autoritetit Suedez që të përmbushë kërkesat e raportimit, siç përshkruhet në Dispozitat e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet.

B. Pavarësisht nga rregullat e pranuar të raportimit, Marrësi dhe SIDA do të informojnë menjëherë njëri-tjetrin nëse bëhet e pamundur që të arrihen objektivat e Projektit ose nëse ndodh ndonjë rast tjetër që mund të ndikojë negativisht në zbatimin e Projektit ose nëse qëllimi i punës devijon nga planet dhe afatet kohore të rëna dakord.

§ 7. Auditimi dhe monitorimi

Autoriteti Suedez do të kryejë auditime të fondeve suedeze siç përcaktohet në dispozitat e

përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet

Marrësi do të asistojë dhe bashkëpunojë me Autoritetin Suedez dhe SIDA-n, duke monitoruar progresin dhe performancën e Projektit dhe do të ndihmojë në vlerësimet e pavarura.

§ 8. Të drejtat e autorit dhe informacioni

Marrësi dhe SIDA mund të përdorin lirisht dokumentacionin e përgatitur brenda Programit/Projektit dhe të paguar nga SIDA.

§ 9. Ligji në fuqi dhe mosmarrëveshjet

Kjo Marrëveshje do të zbatohet sipas ligjit material të Suedisë dhe mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve midis palëve.

§ 10. Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi të jetë nënshkruar nga të dyja palët dhe sapo Ministria e Financave dhe Ekonomisë ta njoftojë SIDA-n me shkrim se procedurat e brendshme të bazuara në legjislacionin shqiptar, të cilat janë të nevojshme që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi, janë plotësuar dhe do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021, përveç nëse përfundon më herët me njoftim me shkrim tre muaj para nga Marrësi ose SIDA.

Çdo zgjatje e periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nëpërmjet Marrëveshjes me shkrim midis palëve dhe çdo zgjatje e periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së Projektit ose dokumentit të ngjashëm të financuar nga kjo Marrëveshje, do të kërkojë miratimin paraprak me shkrim nga SIDA.

Janë hartuar dy origjinale teksti të kësaj Marrëveshjeje, nga të cilat secila Palë ka marrë një kopje dhe një kopje e saj do t'i jepet edhe Autoritetit Suedez.

Vendi dhe data
Për Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)

Nënshkrimi
Birgitta Jansson,
Këshilltare, përgjegjëse e Sektorit për
Zhvillim dhe Bashkëpunim në
Ambasadën Suedeze në Shqipëri
Emri dhe titulli me shkronja të mëdha

Vendi dhe data
Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Nënshkrimi
Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Emri dhe titulli me shkronja të mëdha

**Shtojcat:**

Shtojca 1. Dokumenti i Projektit, duke përfshirë analizën e buxhetit

Shtojca 2. Dispozita e përgjithshme e SIDA-s për Bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve

**Bashki të Fuqizuara
në Shqipëri**

**Rritja e të ardhurave
nga Taksë e Pronës**

**Taksë e Pronës
e bazuar në Vlerën e Tregut**

**Një funksionim
më i mirë i ekonomisë**

**Përmirësimi i
Rregulloreve për
Taksën e Pronës**

**Tatimpagues të
Mirë-përgatitur**

**Regjistrat e
Plotë për
Taksën e
Pronës**

**Zbatimi i
Sistemit të
Centralizuar
të TI-së**

**Zbatimi i
Proceseve të
Biznesit**

ProTax Albania | Projekt Plan

**Projekt për Zbatimin
e Taksimit të Pronës në Bazë të Vlerës së Tregut në
Shqipëri
Versioni 0.93**

Informacioni i Dokumentit

Autori

Ulf Mathiasson, Agjencia Tatimore e Suedisë

Historiku i Rishikimeve

Data	Versioni	Komenti	Nënshkrimi
141212	0.1	Drafti i parë	UM
150322	0.4	Drafti i katërt, i dërguar në MF për diskutim	UM
170427	0.5	Rishikuar nga MF	MoF
170625	0.6	Rishikuar pas misionit të gjetjes së fakteve -maj	UM
171027	0.7	2017	UM
171201	0.8	Rishikuar pas misionit të gjetjes së fakteve- shtator	UM
171206	0.9	2017	UM
180112	0.91	Përditësuar pas rishikimit nga MFE	AL
180207	0.92	MFE-ja ka shtuar kapitullin 4.2 për PIU-n	UM
180220	0.93	Ka përfunduar Kapitulli 6 për riskun	UM
		Është përditësuar pas rekomandimeve nga TQAC-ja	
		Është korrigjuar gabimi i rumbullakosjes në kapitullin 7, Buxheti	

Referencat

Matrica e Kuadrit Logjik ProTax Albania	v 1.2
Buxheti dhe Personeli i ProTax Albania	v 1.2
Kriteret Afatshkurtra të ProTax Albania	v 1.0
Organizimi i ProTax Albania	v 1.1
Matrica e Riskut të ProTax Albania	v 1.0



Konceptet dhe shkurtime

ACRP/ATP	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (ndryshuar në Agjencia e Trajtimit të Pronave)
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
CAMA	Vlerësim masiv me kompjuter
CORINE	Koordinimi i Informacionit për Mjedisin i iniciuar nga BE-ja
EFF	Facilitet i Zgjeruar Fondesh
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
FMN	Fondi Monetar i Zhvillimit
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
ZRPP	Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme
Lantmäteriet	Autoriteti për Vendosjen në Hartë, Regjistrimin e Tokës dhe Kadastra
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MoF	Ministria e Financave (ishte në vjeshtë 2017, u riorganizua dhe u emërtua MFE)
MIA	Ministria e Punëve të Brendshme
NAIS	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RRKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
NHA	Agjencia Kombëtare e Banesave
AKPT	Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
Pronë	Koncepti “pronë” ndonjëherë përdoret si sinonim me banesën, p.sh. njësi e objektit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
TAIS	Sistemi Informativ për Administratën Tatimore

1. Pse | Qëllimi dhe synimet

1.1 Historiku

Qeveria shqiptare ka vendosur të modernizojë dhe të forcojë sistemin shqiptar të taksimit të pronës. Reforma ka filluar si pjesë e një rregullimi më të gjerë fiskal dhe programit të reformës strukturore, të iniciuar si pjesë e një programi trevjeçar (2014–2016) të FMN-së dhe është konsideruar si një nga fushat kryesore për përmirësimin e performancës. Ai përfshin zbatimin e një sistemi modern për taksimin e pasurisë së paluajtshme, duke u bazuar në vlerën e tregut.

Një objektivi kryesor i reformës ishte rritja e rendimentit aktual shumë të ulët të taksimit të pronës. Një tjetër element kryesor është procesi i reformës strukturore afatmesme që ka transformuar në mënyrë themelore sistemin e financave ndërqeveritare, duke konsoliduar qeveritë lokale në njësi më të mëdha dhe

financiarisht të qëndrueshme, me taksimin e pronës që do të dalë potencialisht si një burim më i fuqishëm i financave lokale.

Gjatë vitit 2014, Ministria e Financave (MF) në Shqipëri kreu një vizitë studimore në Kosovë për të vëzhguar sistemin e tyre të taksimit të pronës dhe Projektin e sapofilluar, ProTax2, i cili përfshin taksimin e ndërtesave dhe tokës. Sistemi i Taksimit të Pronës në Kosovë është zhvilluar në bashkëpunim me Agjencinë Tatimore Suedeze dhe si rrjedhojë, Ministria e Financave organizoi një takim me Departamentin e Taksave të Pronës së Kosovës, Agjencinë Suedeze të Taksave dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Në vitin 2016, Ministria Shqiptare e Financave dhe Ministria e Financave të Kosovës nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në lidhje me ndihmën që do të sigurohet nga qeveria e Kosovës për Kadastrën Fiskale. Më



konkretisht, autoritetet kosovare kanë rënë dakord të ndihmojnë Ministrinë Shqiptare të Financave me zbatimin e Sistemit të Kadastrës Fiskale (në formatin e programit kompjuterik), trajnimin e stafit, si dhe ndarjen e përvojës që ata kanë pasur gjatë përdorimit të sistemit.

Në fillim të vitit 2017, Ministria e Financave e Shqipërisë i kërkoi SIDA-s që të shqyrtojë mundësitë e ndihmës në reformimin e sistemit të taksave mbi pronën. Si pjesë e kësaj, SIDA i kërkoi Agjencisë Suedeze të Taksave të kryejë një mision të ri për gjetjen e fakteve në maj të vitit 2017. Pas këtij misioni, Ministria e Financave kërkoi një version të propozimit të Projektit nga viti 2015 për t'u përditësuar me gjetjet nga misioni i fundit.

Ky dokument është rezultat i asaj kërke.

1.2 Qëllimi i Projektit

Bashki të fuqizuara në Shqipëri

Qëllimi i Projektit është të kontribuojë në forcimin e bashkive në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm të ardhurat e tyre vetjake, duke zbatuar taksimin e pronës së paluajtshme *bazuar në vlerën e tregut* për ndërtesat, pra njësitë e objekteve.

1.3 Synimet e zhvillimit | Rezultati

Rritja e të ardhurave nga taksat e pronës	Taksa e pronës bazuar në vlerën e tregut	Një funksionim më i mirë i ekonomisë
---	--	--------------------------------------

Projekti ka tri qëllime kryesore zhvillimi që duhet të arrihen në planin afatgjatë, pas mbylljes së Projektit. Megjithatë, pjesë të tyre do të realizohen tashmë gjatë periudhës së Projektit. Secili prej qëllimeve zhvillimore përshkruhet në kapitujt e mëposhtëm. Për detaje për këto qëllime, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

1.3.1 Rritja e të ardhurave nga taksimi i pronës

Aktualisht, të ardhurat nga taksimi i pronës në Shqipëri janë shumë të ulëta. Sipas disa burimeve nuk janë më shumë se 0.32% e PBB-së në vitin 2016. FMN-ja rekomandon që të ardhurat nga taksimi i pronës të jenë të paktën 0.70% të PBB-së në të ardhmen. Një qëllim afatgjatë mund të jetë rritja e të ardhurave deri në 1% të PBB-së; një për qind për bashkinë.

Një ambicie realiste si rezultat i Projektit të përshkruar në këtë dokument mund të jetë arritja nga 0.5% në 0.8% e PBB-së ose më shumë se 50 milionë euro.

1.3.2 Sistemi i taksimit të pronës në bazë të vlerës së tregut

Sistemi i ri i taksimit të pronës i bazuar mbi vlerën e tregut do të jetë i drejtë, efikas, efektiv dhe transparent.

I drejtë

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë i drejtë:

- Vlera e tregut e ndërtesave (njësive të objekteve) si bazë për taksim në vend të një tarife të bazuar në zonë;
- taksimi, gjithashtu, mbi ndërtesat pa leje;
- të paktën 90% e të gjitha ndërtesave (njësive të objekteve) të regjistruara për taksim;
- taksimi i zbatuar në të gjitha bashkitë;
- shkalla e lartë e akumulimit (të paktën 80%).
- Garantohet siguria juridike që do të thotë:
- krijimi i një baze ligjore të qartë, të saktë dhe të parashikueshme

- shmangia e ushtrimit të dispozitave me efekt prapaveprues

- krijimi i rregullave dhe procedurave të hollësishme, për të siguruar qartësi dhe udhëzime mbi elementet themelore të taksimit të pronës;

- njëسيا qendrore ka të drejtë të nxjerrë vendime detyruese unifikuese për të siguruar trajtim të barabartë në të gjitha bashkitë;

- aktet normative, vendimet ose informacione të tjera të nevojshme zyrtare vihen në dispozicion të publikut dhe çka është më e rëndësishmja, të tatimpaguesit.

Efikas

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë efikas:

- shërbimet elektronike të publikuara për të gjitha llojet e nevojave të tatimpaguesve të pasurisë;
- procesi i vlerësimit është i centralizuar;
- procesi i taksimit është i centralizuar dhe i automatizuar;

- harmonizimi i pagesave është i automatizuar;

- vendosja e sistemit të centralizuar të TI-së (TI - Teknologjisë së Informacionit).

Efektiv

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë efikas:

- të paktën 90% e të gjitha njësive të objekteve të regjistruara në sistemin e taksimit të pronës;
- do të akumulohet të paktën 80% e taksës së vlerësuar të pronës.

Transparent

Projekti do të punojë gjerësisht me informacionin për tatimpaguesit (shihni kapitullin 2.2) për t'i fuqizuar ata për të marrë pjesë në



reformën e taksimit të pronës. Reforma synon transparencën më të madhe të mundshme:

- të gjitha ngjarjet në sistemin TI të taksimit të pronës të ruajtura dhe lehtësisht të aksesueshme për auditim;

- baza për vlerësim (hartat e vlerave të zonës, përshkrimet, nivelet e vlerës, çmimet e shitjes, modeli i vlerësimit) të aksesueshme publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;

- të ardhurat dhe shpenzimet bashkiake të aksesueshme për publikun në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;

- regjistri i çmimi të shitjes i aksesueshëm publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;

- vlerat e vlerësuara të aksesueshme publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;

- borxhet e taksimit të pronës të aksesueshme publikisht (ose të paktën për bankat).

1.3.3 Një ekonomi që funksionon më mirë

Një ekonomi më funksionale është një ndikim më i tërthortë, por sërisht shumë i rëndësishëm i Projektit të planifikuar. Ekzistojnë të paktën tri mënyra që pritet të ndikojnë në ekonominë e Shqipërisë.

Një mjedis i përmirësuar i biznesit

Një taksë e qartë e pronës është një mënyrë e parashikueshme, transparente dhe e qëndrueshme për bashkitë për të mbledhur fonde dhe në këtë mënyrë, një kusht për një mjedis të mirë biznesi.

Një treg pronash që funksionon më mirë

Një vlerë zyrtare e taksueshme për ndërtesat (njësitë e objekteve) do të kontribuojë për një treg më transparent të pasurive të paluajtshme. Një treg më transparent do ta bëjë më të lehtë për investitorët që të marrin pjesë në të. Gjithashtu, do të jetë më e lehtë të ndiqni ndryshimet në çmimet e pronës. Këto ndryshime janë një bazë e rëndësishme për vendimet ekonomike dhe politike. Shumë nga këto vendime janë të lidhura me një treg kreditimi që funksionon mirë.

Një treg kredish që funksionon më mirë

Një vlerë e vlerësuar e pronës, e konfirmuar nga shteti, mund të përdoret si bazë për marketingun e kredive dhe do të zvogëlojë nevojën për një vlerësim të vetëm të pronave. Mund të jetë, gjithashtu, baza për marketing kreditimi nëse sistemet TI përdoren nga aktorët në tregun e pasurive të paluajtshme për proceset e brendshme

efikase në gjykimin e vlerave. Në afat të gjatë kjo do të çojë në interesa më të ulëta për marketingun e kreditimit të pronave në tregun e pasurive të paluajtshme.

1.3.4 Perspektiva gjinore

Arritjet në kuadrin rregullator gjatë viteve të fundit kanë përcaktuar garanci të fuqishme për të drejtën e grave për të zotëruar pronë. Megjithatë, ato kanë qenë të pamjaftueshme për të sjellë ndryshimin e dëshiruar për përmirësimin e barazisë gjinore.

Pavarësisht faktit se gratë në Shqipëri përbëjnë përafërsisht gjysmën e popullsisë, shumica e pronave janë të regjistruara në emër të burrave. Dy pengesa kryesore, ndër të tjera, kanë kontribuar për këtë. Informaliteti në sektorin e pronës dhe pengesat kulturore që rrjedhin nga ligji zakonor i vjetër.

Informaliteti është dominues duke pasur parasysh numrin e madh të ndërtesave pa leje që nuk legalizohen dhe pronat e tjera që nuk janë të regjistruara në ZRPP. Ritmi i ngadaltë i procesit të formalizimit i ka penguar gratë të regjistrohen dhe të ushtrojnë plotësisht të drejtën e tyre për pronë.

Gjithashtu, ato herë pas here përballen me vështirësi për të trashëguar pronën nga prindërit ose bashkëshorti, si dhe për të regjistruar pasurinë në emër të tyre, për shkak të presionit social, traditës dhe normave kulturore. Për shkak të këtyre faktorëve, ato heqin dorë nga të drejtat e trashëgimisë së tyre në favor të anëtarëve meshkuj të familjes ose ngurrojnë të regjistrojnë pronën në emër të tyre.

Projekti do të kontribuojë në përshpejtimin e procesit të formalizimit të të drejtave të pronës në Shqipëri dhe do të ndihmojë në përfundimin e tij në kohë të arsyeshme, duke ofruar informacione të konsiderueshme e të dobishme për pronën tek ALUIZNI dhe ZRPP-ja.

